



Erasmus+

**Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte e Universitetit Publik
"Kadri Zeka", në Gjilan,**

shpall këtë:

**Thirrje për aplikime për shkëmbim studentor
në Universitetin "Çukurova University" Adana,
Turqi**

Universiteti Publik "Kadri Zeka", është pjesë e projektit KA171 ICM, 2022-2027, Erasmus+, në partneritet me Universitetin e Çukurova University, Adana, Turqi.

Programi Erasmus + KA171 ose Shkëmbimi afatshkurtër dhe afatgjatë i studentëve dhe ECTS (ICM) është një program i mobilitetit plotësisht i financuar që mundëson shkëmbimin e studentëve, stafit mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës midis Universitetit të Çukurova University nga Turqia dhe Universitetit "Kadri Zeka", në Gjilan.

ICM Erasmus + mundëson shkëmbimin e studentëve nga Universiteti "Kadri Zeka" – Gjilan për studim dhe trajnim / veprimtari të lëvizjes në fusha të ndryshme, ku në këtë thirrje do të kenë mundësi që një semestër ta përfundojnë në Universitetin e Çukurova.

Të gjitha shpenzimet janë të mbuluar nga projekti sipas Distance Calculator të Erasmus +:

<https://erasmus-plus.ec.europa.eu/resources-and-tools/distance-calculator>

Granti i udhëtimit do të paguhet para lëvizjes nga projekti dhe mbulohet nga Universiteti pritës.

Shënim:

- 1) Të gjithë pjesëmarrësit duhet t'i përmbahen kufizimeve të alokuara buxhetore pasi që nuk ka fonde shtesë.
- 2) Buxheti i udhëtimit llogaritet sipas llogaritësit të udhëtimit dhe edhe nëse tarifa e biletës tejkalon shumën e mbështetjes së udhëtimit, nuk mund të jepen fonde shtesë për pjesëmarrësit.



Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Certifikata e notave;
- CV (në gjuhën angleze);
- Një letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim studentit (i lëshuar nga fakulteti juaj që konfirmon nivelin tuaj dhe vitin e studimit gjatë këtij viti akademik, jo më të vjetër se 30 ditë);
- Kopje e pasaportës (faqja që përmban emrin tuaj, fotografinë dhe të dhënat personale) ose Letërnjoftimit;
- Certifikata e gjuhës angleze;

Për programet e ofruara në gjuhën angleze kërkohet niveli i gjuhës B2.

1. Studenti duhet të ketë të përfunduar të paktën 2 semestra në programin në të cilin janë regjistruar. Deri në ditën e fundit për aplikim, studentët të cilët kanë notë mesatare mbi 8.00 mund të aplikojnë në program.
- 2). Që studentët të marrin një grant të ICM-se, ata duhet të kalojnë të paktën një semester (3 muaj) në universitetin pritës. Granti i mobilitetit të studenteve të ICM mbulon minimumi 90 dite.
- 3). Studentët që do të marrin pjesë në programet e mobilitetit janë të detyruar të marrin kurse nga universiteti pritës të pakten me vlerë 30 ECTS (rreth 5 kurse).

Vlerësimi i aplikantëve:

- Mesatarja e notës: 50%
- Gjuhë e huaj: 50%

PROCEDURA E APLIKIMIT

- Aplikimet duhet të dorëzohen në Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar (kopje fizike), në mes të datave 12.07.2023 deri 31.07.2023.

Aplikimet e vonuara nuk do të pranohen.

- Rezultatet e aplikimit do të shpallen në www.uni-gjilan.net

Për çdo informatë shtesë, kontaktoni zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar në UKZ.

Me respekt,



Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka
Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte